

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Erdogan Haxhibeqiri, kryetar kolegji, Gyltene Sylejmani dhe Isa Kelmendi anëtarë, në çështjen kontestimore të paditësit, V. B.,nga komuna ..., të cilin e përfaqëson avokati M. B., nga ..., kundër të paditurës KEK-Divizioni i furnizimit –Distrikti-Gjakovë,të cilën e përfaqëson Bekim Ademi, për kompensimin e të ardhurave personale, përkitazi me revizionin e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ac.nr.118/2014 datë 25.05.2018, në seancën e kolegjit mbajtur më 13.11.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i të paditurës i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, Ac.nr.118/2014 datë 25.05.2018.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit, Ac.nr.118/14 datë 25.05.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë- Dega në Rahovec, C.nr.155/12 datë 21.11.2013,me të cilin në pjesën I të dispozitivit të aktgjykimit është aprovuar kërkesë padia e paditësit V.B., nga Komuna e ..., dhe është detyruar e paditura Korporata Energjetike e Kosovës- Divizioni i furnizimit distrikti në Gjakovë, që paditësit në emër të kompensimit të pagave – të ardhurave personale, duke filluar prej datës 10.09.2010 e përfundimisht me 17.09.2012,t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej 12.074,00€ ku është përfshirë edhe kamata, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi me kërcënim përmbartimi me dhunë. Me pjesën II të diapozitivit është obliguar e paditura që po në të njëjtin afat paditësit t'ia kompensoj edhe shpenzimet procedurale në shumë prej 778.36€.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, e paditura me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, revizionin t`ia pranoj si të bazuar, të ndryshoj aktgjykimet e gjykatave të instancës ma të ulët dhe t`ia refuzoj kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar.

I autorizuari i paditësit me kohë ka paraqitur përgjigjeje në revizioni e të paditurës me propozim që i njëjti të refuzohet si i pa bazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi tek e paditura ka themeluar marrëdhënie pune dhe ka kryer punë dhe detyra të punës koordinator i ND në Rahovec për periudhën kohore prej dt. 21.09.2010 e deri më 17.09.2012 dhe atë sipas kontratës së punës të nënshkruar me të paditurën, ndërsa paditësit për këtë periudhë nuk i janë kompensuar të ardhurat personale të cilat i kanë takuar në bazë të kontratës së punës dhe punëve të kryera. Bazën juridike të kërkesëpadisë gjykata e ka vërtetuar nga aktgjykimi i plotëfuqishëm i gjykatës Komonale në Rahovec C.nr.284/2010 dt. 04.03.2011 me të cilin është anuluar si kundërligjshëm njoftimi i të paditurës për ndërprerjen e mërdhezjes së punës paditësit, si dhe është detyruar e paditura ta kthej paditësin në vendin e tij të punës. Në lidhje me lartësinë e të ardhurave personale të cilat i kanë takuar paditësit, gjykata e shkallës së parë e ka vërtetuar nga tabelari mbi llogaritjen e pagave të llogaritura nga personeli i sektorit të pagave të të paditurës nr. 3413 dt. 21.11.2013, në të cilën është shprehur shprehimisht shuma e të ardhurave të pa paguara paditësit në shumë prej 12,074.00€.

Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit dhe vlerësimit të shkresave të lëndës, në seancën e shqyrtimit kryesor ka nxjerr aktgjykimin e atakuar C.nr.155/12 datë 21.11.2013, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit duke vendosur si në aktgjykimin e atakuar.

Gjykata e shkallës së dytë, në procedurën ankimore ka gjetur se gjykata e shkallës së parë, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, i ka zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale, kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, prandaj ka refuzuar si të pabazuar ankesën e të paditurës dhe ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë. Sipas vlerësimit të gjykatës ankimore, aktgjykimi i shkallës së parë nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat ajo gjykatë obligohet të kujdeset sipas detyrës zyrtare (ex-officio).

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, ka gjetur se gjykatat e shkallës së dytë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale, kur ka gjetur se ankesa e të paditurës është e pa bazuar dhe ka refuzuar ankesën e të paditurës ashtu që aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar duke dhënë arsye të plota të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe ai i goditur përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet relevante, të vlefshme për gjykimin e drejt të kësaj çështjeje juridike dhe se aktgjykimet e tyre nuk përmbajnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat kjo Gjykatë i vëren sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Supreme e Kosovës, vlerëson se gjykatat e instancës ma të ulët drejtë kanë aplikuar të drejtën materiale kur kanë gjetur se nuk është kontestuese fakti se midis palëve ndërgjygjëse, se paditësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura, në vendin e punës koordinator i ND në Rahovec, e po ashtu nuk ka qenë kontestuese edhe fakti se paditësit për periudhën kohore prej 10.09.2010 e deri më 17.09.2012, nuk i janë paguar të ardhurat personale në lartësinë e kërkuar. Në fakt edhe e paditura, gjatë shqyrtimit kryesor, por edhe në ankesë e ka pranuar faktin se paditësit nuk i janë kompensuar të ardhurat personale par periudhën kontestuese.

Gjykata Supreme e Kosovës i vlerësoi si të pa bazuara thëniet e të paditurës në revizion se; gjykatat e instancës ma të ulët gabimisht kanë aplikuar të drejtën materiale, kur kanë aprovuar kërkesëpadinë e paditësit nga se gjykatat e instancës ma të ulët nuk kanë vlerësuar në mënyrë të drejtë provat e prezantuar nga e paditura pasi që kompensimi i të ardhurave personale gjatë kohës sa paditësi nuk ka qenë i punësuar tek e paditura, se i njëjti nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën do të dëshmonte se gjatë kësaj periudhe ka realizuar të ardhura tjera nga ndonjë marrëdhënie tjetër pune, sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë dhe të drejtë ka vlerësuar të gjitha provat e administruara duke dhënë arsye të plota për secilën provë veç e veç në arsyetimin e aktgjykimin të saj,

po ashtu edhe gjykata e shkallës së dytë ka dhënë arsye të plota për faktet vendimtare në arsyetimin e aktgjykimit të saj të cilat arsye janë të pranueshme edhe për këtë gjykatë.

Si rrjedhojë e kësaj është detyrim ligjor i të paditurës që paditësit si në rastin konkret t`ia kompensoj të ardhurat personale për punën e kryer edhe atë në bazë të nenit 55 par. të Ligjit të Punës, ku thuhet se *“punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”* .

Gjykata Supreme e Kosovës i vlerësoi si të pabazuara edhe thëniet e të paditurës në revizion se aktgjykimi është marrë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182.2(n) të LPK, nga se diapozitivi i aktgjykimeve të gjykatave të instancës ma të ulët janë të kuptueshme nuk janë në kundërtënie me vetveten dhe arsyet e aktgjykimit dhe përmbajtjes së dokumentave-provave që gjinden në shkresa të lëndës .

Në bazë të asaj që u tha më sipër dhe me zbatimin e nenit 222 dhe nenit të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr. 364/2018, më 13.11.2018

Kryetar i kolegjit,
Erdogan Haxhibeqiri